



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM ELBASAN



Nr. 656/1 Prot
Tiranë, më 03 . 03 .2025

Nr. 2402/1 Prot
Elbasan, më 04 . 03 .2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS

DHE

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

*“Për sigurimin e zyrës së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore
pranë ambienteve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të
Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, pa kundërshtim”*

Sot më datë, 04.03.2025, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas me adresë: Rr. “Jordan Misja”, Godina nr.3, Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, në mungesë, Drejtori i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndihmës Parësore, Zj. Patricia Pogaçe

dhe

Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

me adresë: Rruga Koco Brisku 5, Elbasan, përfaqësuar nga Z. Kreshnik Ajazi, Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, këtu e në vijim “*Prokuroria*”

Duke qenë së Palët:

Vlerësojnë, rëndësinë e përmirësimit të administrimit të ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti në favor subjekteve përfituese nga Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Konsiderojnë, se një ndër objektivat kyç në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel qendror dhe vendor është efikasiteti në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në përputhje me nevojat e tyre;

Marrin në konsideratë politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra në nivel legjislativ për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e subjekteve dhe kërkesat për implementimin e suksesshëm të tyre;

Synojnë, implementimin efektiv të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, nëpërmjet aksesit të barabartë në ndihmën juridike, barazisë dhe mos diskriminimit të individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike, profesionalizmit në dhënien e shërbimit të ndihmës juridike, cilësisë, efijencës dhe efikasitetit në kosto për shërbimet e ofruara të ndihmës juridike, ruajtjes së konfidencialitetit, shmangies dhe parandalimit të konfliktit të interesit, mbrojtjes së të drejtave të personave vulnerabël;

Konfirmojnë, angazhimin institucional për të siguruar standarde të larta të veprimtarisë, për të adresuar dhënien e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve, dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore, ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;

Afirmojnë vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshje për të përmbushur angazhimet e ndërmarra në kuadër të instrumenteve ndërkombëtare.

Kanë rënë dakord të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, në vijim e quajtur “*Marrëveshje*”.

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj Marrëveshje është vënia në dispozicion pa kundërshtpërblim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan të një ambienti të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga “Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Elbasan”.

Neni 2 Baza ligjore

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi bazohet në ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Neni 3 Qëllimi

1. Palët bien dakord të bashkëpunojnë me qëllim vënien në dispozicion të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas (*institucion në varësi të Ministrit të Drejtësisë*), të një ambienti të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga “Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Elbasan”.

Neni 4 Roli dhe përgjegjësitë e Palëve

1. Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, merr përsipër:
 - a) Të përdorë ambientin e përcaktuar nga gjykata, vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje dhe brenda kuadrit ligjor në fuqi.
 - b) Të koordinojë punën për ushtrimin e veprimtarisë së Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.
2. Prokuroria, nëpërmjet strukturave të saj merr përsipër:
 - a) Të vendosë në dispozicion një ambient në katin zero dhe konkretisht Zyrën Z.1 në katin 0 për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore me qëllim aksesimin nga të gjitha kategoritë.
 - b) Të garantojë përdorimin e qetë të ambienteve të kësaj zyre.
 - c) Të mbulojë, pa shpenzime shtesë, por në kuadër të funksionimit të rrjetit të internetit dhe energjisë elektrike të të gjithë godinës ku ndodhet zyra, furnizimin me internet dhe energji elektrike edhe të Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.
 - d) Të ofrojë të gjitha lehtësitë në lidhje me përdorimin e zyrës nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore.
 - e) Lehtësi në përdorimin e zyrës brenda orareve zyrtare dhe në respektim me rregulloren e Prokurorisë.
 - f) Lehtësi në përmbushjen e qëllimit të ofrimit të shërbimeve nga Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Elbasan.
 - g) Prokuroria garanton që ambientet e ofruara për të ushtruar detyrat sipas ligjit të jenë të përshtatshme dhe me standarde për të ofruar këto shërbime;

2. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar në pikën 1 të këtij neni, Pala e cila përfaqësohet prej këtij personi do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda 1 (një) javë kalendarike nga data e ndryshimit, të dhënat e personit të ri të kontaktit.
3. Personi i kontaktit nga Prokuroria, i përcaktuar në nenin 7 pika 1 shkronja (a) të Marrëveshjes së Bashkëpunimit autorizohet të verifikojë qëndrimin në punë si dhe të nënshruajë listëprezencat e punonjësve me trajnim të posaçëm të angazhuar pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.
4. Punonjësit me trajnim të posaçëm pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike, duhet të dorëzojnë në baza mujore listëprezencën tek personi i kontaktit dhe më pas ta përcjellin elektronikisht listëprezencën e firmosur pranë Drejtorisë së Financës, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 9

Dispozita të fundit

1. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë Marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 6 të saj.
2. Kjo marrëveshje nuk është burim i krijimit të detyrimeve monetare dhe financiare ndërmjet Palëve.
3. Çdo palë merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshje pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.
4. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
5. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

**PËR PROKURORISË PRANË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN**

**PËR DREJTORINË E NDIHMËS
JURIDIKE FALAS**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
NË MUNGESË**

(DREJTORI I DREJTORISË SË ZBATIMIT TË POLITIKAVE
DHE ADMINISTRIMIT TË NDIHMËS PARËSORE)

DREJTUES I PROKURORISË

Z. Kreshnik Ajazi



Zj. Patricia Pogace

